



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.76**

**27 maj**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.250, datë 15.5.2009	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri.....	3377
Vendim i Kuvendit nr.251, datë 15.5.2009	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri.....	3377
Vendim i Kuvendit nr.252, datë 15.5.2009	Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor “Për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.249, datë 23.4.2009.....	3378
Vendim i Kuvendit nr.253, datë 15.5.2009	Për shpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009.....	3378
Vendim i Kuvendit nr.254, datë 15.5.2009	Për mbylljen e legjislaturës XVII të Kuvendit të Shqipërisë.....	3379
Dekret nr.6130 datë 8.4.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3379
Vendim i KM nr.385, datë 15.4.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman të qarkut të Fierit.....	3380
Vendim i KM nr.401, datë 22.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar.....	3381
Vendim i KM nr.474, datë 6.5.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Llanga 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	3381

Vendim i ERE nr.32, datë 22.4.2009	Për fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k.....	3382
Kërkesë e MPPTT nr.1467/1, datë17.4.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi rrugës nacionale të Saukut.....	3382
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Mentije Marke.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Emin Nesimi.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Hajrulla Nesimi.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Nazmije Goleci.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Zeqir Ismaili.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Fetah Goleci.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Gazie Fida.....	3385
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Abdi Merdani.....	3386
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Meribane Balliu.....	3386
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kadri Nesimi.....	3386
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Sabrije Çupi.....	3386
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Xhile Elezi.....	3386

**VENDIM**  
**Nr.250, datë 15.5.2009**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6169, datë 14.5.2009 të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6169, datë 14.5.2009 për shkarkimin e zotit Anastas Duro nga detyra e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.251, datë 15.5.2009**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.6170, datë 14.5.2009 të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.6170, datë 14.5.2009 për emërimin e zotit Viktor Gumi në detyrën e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.252, datë 15.5.2009**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR “PËR  
HETIMIN E PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE TË DHËNIES SË LEJEVE TË  
NDËRTIMIT NË BASHKINË E TIRANËS”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT  
NR.249, DATË 23.4.2009**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet raporti përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Dërgohet raporti përfundimtar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale për personat që eventualisht kanë abuzuar me detyrën dhe funksionin publik.

III. Konstatohet pavlefshmëria e vendimeve të KRRT-së së Bashkisë së Tiranës së datës 17 prill 2009 dhe ngarkohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive që, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të ndërmarrin masat ligjore në përputhje me nenin 40 pika 6 shkronja “b” të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.253, datë 15.5.2009**

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR  
ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2009**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 87 pika 1 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Sasia e fondeve publike që do t’u shpërndahen subjekteve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 është 65 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.254, datë 15.5.2009**

**PËR MBYLLJEN E LEGJISLATURËS XVII TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9 pika 2 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Legjislatura XVII e Kuvendit të Shqipërisë mbyllet në datën 28.5.2009.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET**  
**Nr.6130, datë 8.4.2009**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:

Evgeniya (Jevgenija) Igor Luca (Okhremenko)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.385, datë 15.4.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,  
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS  
KUMAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kuman të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.481, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Kuman të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Kuman	Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Lloji i transferimit
1-3	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.
4-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.
15-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.
23-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.
27-30	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.
31-40	Varrezat publike
42, 46, 48	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).
43,44,45,47,49,51,56, 65,78,87,89,93	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).
94-107	Infrastrukturë (rrugë vendore)
108-112	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.

**VENDIM**  
**Nr.401, datë 22.4.2009**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË**  
**SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në fund të pikës 3 të vendimit nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen edhe emërtesat:

“-Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve dhe specialistët në DSIK.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.474, datë 6.5.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME**  
**KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LLANGA 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË**  
**PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim) të hidrocentralit “Llanga 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënie e bonusit prej 2 pikëve shoqërisë “M&A International”, sh.p.k, për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Llanga 1”, të kërkojë shprehje të interesit dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.32, datë 22.4.2009**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PURO ENERGY STEBLEVA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa a, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

- Paraqitjen e aplikimit konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**KËRKESË**  
**Nr.1467/1, datë 17.4.2009**  
**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi rrugës nacionale të Saukut.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët, për të cilët, në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 407 931 (katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
**Sokol Olldashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS NACIONALE “SAUK”  
 FSHATRAT: SAUK, MJULL BATHORE, FARKË E VOGËL

Nr.	Pronari	ZK.	Nr. Pas	Arë			Truall			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri, Atësia, Mbiemri			Sip.m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera lekë		
1	Fatos Selman Brahja	3266	27/3	134	395	52930				52930	Konfirmuar nga ZRPP
2	Halit Nuredin Brahja	3266	27/4	37	395	14615				14615	Konfirmuar nga ZRPP
3	Genc Etem Brahja	3266	27/2	30	395	11850				11850	Konfirmuar nga ZRPP
4	Xenita Hasan Farka	2704	198/7				12	2517	30204	30204	Konfirmuar nga ZRPP
5	Xhelal Mustafa Metani	2704	193/9/3				20	2517	50340	50340	Konfirmuar nga ZRPP
6	Tire Mustafa Bathorja	2704	193/10				22	2517	55374	55374	Konfirmuar nga ZRPP
7	Dashamir+Izet Shyqyri Osm	2704	206/16	23	344	7912				7912	Konfirmuar nga ZRPP
8	Trashëgimtarët Gjuzi	2704	206/20	13	344	4472				4472	Konfirmuar nga ZRPP
9	Lumturi Gjuzi	2704	206/19	74	344	25456				25456	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bashkëpronarët Allaraj+Hoxha	2704	230/13	262	344	90128				90128	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nadire Rrushi	2704	217/18				18	2517	45306	45306	Konfirmuar nga ZRPP
12	Agim Sali Muharremi	1605	211/23	52	372	19344				19344	Konfirmuar nga ZRPP
	<b>TOTALI</b>			<b>201</b>		<b>79395</b>	<b>72</b>		<b>181224</b>	<b>407931</b>	

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasës Mentije Marke, e bija e Ramadanit dhe e Meleqes, e datëlindjes 10.8.1928, banuese në Grevë, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Emin Nesimi, i biri i Hajrullait dhe i Tahires, i datëlindjes 20.7.1917, banues në Rabdisht, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Hajrulla Nesimi, i biri i Zeqirit dhe i Sulbijes, i datëlindjes 16.5.1892, banues në Rabdisht, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasës Nazmije Goleci, e bija e Mirvetit dhe e Beres, e datëlindjes 9.4.1920, banuese në Rabdisht, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Zeqir Ismaili, i biri i Xheladinit dhe i Vahides, i datëlindjes 17.1.1916, banues në Rabdisht, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Fetah Goleci, i biri i Veliut dhe i Hazbies, i datëlindjes 20.3.1916 banues në Rabdisht, Komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasës Gazie Fida, e bija e Seferit dhe e Linditës, e datëlindjes 12.5.1994, banuese në Grevë, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Abdi Merdani, i biri i Sinanit dhe i Nazes, i datëlindjes 10.10.1890, banues në Grevë, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Meribane Balliu, e bija e Shahinit dhe e Razijes, e datëlindjes 25.2.1974, banues në Pjeçë, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Kadri Nesimi, i biri i Hajrullait dhe i Tahires, i datëlindjes 16.9.1919, banues në Rabdisht, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Sabrije Çupi, e bija e Jasharit dhe e Danes, e datëlindjes 8.2.1908, banuese në Pjeçë, komuna Melan.

#### KËRKESE

Zyra e gjendjes civile e komunës Melan, përfaqësuar nga përgjegjësjja e zyrës znj.Vaska Jonuzi, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Xhile Elezi, e bija e Hazizit dhe e Mines, e datëlindjes 14.9.1900, banuese në Bellovë, komuna Melan.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.**

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE .....	240 lekë
KODI PENAL .....	226 lekë

Hyri në shtyp më 27.5.2009  
Doli nga shtypi më 27.5.2009

Tirazhi: 3300 copë
--------------------

Formati: 61x86/8
------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 14 lekë